

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	'Mos kujtoni se ju kam vjedhur'/ Këlliçi-Ramës: Je kreu i narkoshtetit dhe kryehajduti i shqiptarëve, jep m enjëherë dorëheqjen
ADRESA	https://piranjat.al/politike/mos-kujtoni-se-ju-kam-vjedhur-kellici-rames-je-kreu-i-narko-shtetit-dhe--i106340
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 18:17:51 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 18:10:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3c8b2689ca309c7cb28f4012a3cc664ebcac08fd7510cea5b7fb4e39c45684e7
TEKSTI	d43c4c049574b482dc2647fdf26d1b6e1d29d714e67a8fe7d7a21a811dc20586
PAMJA	9985e992fe9826735d975ed1322afc3403a575217835d10fc6a3b9ec37921691

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	02a958c3cd4001e46f0859725a9b17aecaefca8fb59074e9ab712df2c2a190dc
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b1c7a27947b4cc546e59bf39e541eaf49f294f8d53ee0afce777d7f589624631
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/02a958c3cd4001e46f0859725a9b17aecaefca8fb59074e9ab712df2c2a190dc>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: dhe kryehajduti i Edi Rama në Rinas, pasi e kishte njoftuar për konferencë, duke e akuzuar atë për korrupsion, abuzim me pushtetin dhe përgjegjësi për krizën politike e institucionale në vend.

jetën nga zjarri në shtëpi

minimale "shembull" nga familjet

me ndëshkim!

Si ndodhi ngjarja

Marculino Osmani, ka h...

kërku nga S

[POLITIKE](#)

‘Mos kujtoni se ju kam vjedhur’/ Këlliçi-Ramës: Je kreu i narkoshtetit dhe kryehajduti i shqiptarëve, jep menjëherë dorëheqjen

Piranjat Përditësimi i fundit 27 Shtator 2026, 20:10



Nënkryetari i Partisë Demokratike, Belind Këlliçi, ka reaguar pas monologut të Edi Rama në Rinas, pasi e kishte njoftuar për konferencë, duke e akuzuar atë për korrupsion, abuzim me pushtetin dhe përgjegjësi për krizën politike e institucionale në vend.

Në deklaratën e tij, Këlliçi tha se Rama shmangu përballjen me pyetjet e gazetarëve dhe e cilësoi konferencën e tij si një 'monolog'.

Nënkryetari i PD-së i pamendi Ramës lidhjet e tij me çështjet e korrupsionit dhe procedurave publike. Ai përmendi ndër të tjera inceneratorin e Tiranës, koncesionet në shëndetësi, Portin e Durrësit dhe disa projekte infrastrukturore.

Këlliçi akuzoi gjithashtu Ramën se ka përdorur shumicën parlamentare për të penguar hetimet ndaj zyrtarëve të qeverisë.

Këlliçi kërkoi dorëheqjen e menjëhershme të Edi Ramës. 'Prandaj kërkohet dorëheqjen e menjëhershme të Edi Ramës, si kusht themelor, për zgjidhjen e krizës së gjithanshme, që ka kapluar dhe shkatërruar vendin tonë', deklaroi nënkryetari i PD-së.

Deklarata e nënkryetarit të PD, Belind Këlliçi:

Edi Rama i thirri gazetarët në Rinas për një konferencë të jashtëzakonshme shtypi, por, i frikësuar nga pyetjet, iu kthye monologut të zakonshëm. Foli si një jerm për armiqtë e brendshëm dhe sukseset e mëdha që, sipas tij, këta armiq i pengojnë.

Përçarja e Ramës lidhet edhe me atë që ndodhi në Neë York: foli për inteligjencën artificiale dhe akuzoi popullin e tij si antisemit, në një sallë krejt të boshatisur, ndërsa Vuçiçi ia la fjalën për Kosovën. Atje u prit me protesta, duke nisur nga takimi i parë në Michigan, dhe pas bojkotit total, takimet e vetme që realizoi janë ato me Taulant Ballën dhe Pjerin Ndreun.

U kthye nga Neë York, ku e pritën me protesta dhe përcëim pas shpenzimeve përrallore, të denja vetëm për kreun e një Narkoshteti. Fjalimi i tij për Diellën, i shkruar nga ChatGPT, ngjalli neveri. I rënduar nga barra e çështjeve që rrethojnë qeverisjen e tij, në vend që të dilte përpara gazetarëve, siç kishte njoftuar, u struk në një monolog të turpshëm. Motoja e tij ishte: 'Mos kujtoni se ju kam vjedhur'.

Në monologun e tij të vetposhtërimit, Padrino, njëllor si në rastin e Lubisë, bëri avokatinë e Vlora Hysenit, kësaj zyrtareje pa moral, pa dinjitet dhe pa atdhe, që u emërua në atë detyrë të besimit më të lartë shtetëror, në kundërshtim me çdo kriter e parim. Merita e vetme e saj ishte shkarkimi nga autoritetet e Kosovës për grabitje dhe dorëzim në Beograd, të të dhënave të Shërbimit Informativ të Kosovës.

Me këtë avokati, Edi Rama dëshmon se ai nuk është peng vetëm i Lubisë, bashkëhajdutes dhe noteres së vjedhjeve të tij prej 27 vitesh, por dhe i Ergys Agasit, Ermal Beqirit dhe Vlora Hysenit, e cila si anëtare kryesore e kësaj organizate të rrezikshme kriminale, si shërbëto e fëlliqur e karteleve të drogës, si kurizane e koordinatorit famoz të bandave dhe karteleve, vuri në shërbim të këtyre të fundit, me miratimin e Edi Ramës, institucionin e Shërbimit Informativ Shtetëror, sigurinë kombëtare dhe sekretet që Aleanca e Atlantikut të Veriut ua beson vendeve anëtare.

Betimet e tij se ai nuk ka vjedhur, në fakt provojnë të kundërtën.

Ti, Edi Rama, je njeriu që ke shkarkuar në mënyrë antikushtetuese kryetaren e ILDKP-së, sapo ajo nisi hetimin për pallatin pesëkatësh të bashkëshortes tënde, të marrë në pajë: një ndërtesë pa fatura doganore, tatimore, bankare apo ndërtimore, e ngritur nga një kompani që fitoi qindra milionë euro në tendera.

Ti, Edi Rama, je njeriu që, në shkelje të Kushtetutës, shkarkove kryetaren e ILDKP-së, sapo ajo nisi hetimin për saralet e tua: me themele 57 metra të gjata dhe park prej 8,300 metrash katrorë, më të mëdha se Pallati Presidencial, të ndërtuara në një kohë kur ti kishe deklaruar vetëm 3,800 euro dhe 400 mijë lekë kursime.

Ti, Edi Rama, je njeriu që je akuzuar në një raport zyrtar të OSBE-së të vitit 2014 për 200 milionë euro të fshahura në banka offshore

Edi Rama, je njeriu qe je akuzuar personalisht dhënie e 130 milionë eurove për inceneratorin e Tiranës, tetë muaj përpara se të themelohej kompania së cilës ia dhe.

Ti, Edi Rama, je njeriu që je akuzuar drejtpërdrejtë, për transportimin jashtë vendit, me avionin tënd, të qindra valixheve me euro, por refuzove ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar.

Ti, Edi Rama, je kryehajduti i shqiptarëve, më i madhi i të gjitha kohërave, autori i vërtetë i koncesioneve të sterilizimit, Check-Up-it dhe analizave, përmes të cilave, së bashku me ministrat e tu, keni vjedhur të paktën 300 milionë euro.

Ti je hajduti që, së bashku me Alabari-n tënd, ke vjedhur trull publik me vlerë 3 miliardë euro në Portin e Durrësit.

Ti, Edi Rama, je i vetmi kryeministër që ke përdorur mandatet parlamentare për të bllokuar drejtësinë, jo një, por dy herë. Nuk ia hoqe imunitetin Tahirit, sepse kishe ndarë me të përfitimet e trafiqeve. Nuk ia hoqe imunitetin Ballukut, sepse dosja e saj, me qindra milionë euro në tunelin e Llogarasë, Unazën e Madhe të Tiranës, Rrugën e Arbrit, Aeroportin e Vlorës dhe rrugën Qukës-Qafë Plloçë, është para së gjithash dosja jote, siç dëshmohet, sipas nesh, në çdo faqe të saj.

Ti, Edi Rama, je kryehajduti i shqiptarëve në tërë historinë e tyre. Për të shkatërruar përfundimisht sistemin e prokurimeve, ke shpikur modelin ‘KAYO’: me të cilin mallrat e blera me paratë e taksapaguesve ia shesin qeverisë tënde të korruptuar, dhe fitimin e ndajnë me ty.

Mund ta kthesh konferencën e shtypit në monolog.

Por sot çdo shqiptar, në fytyrën tënde që nxin, shikon fytyrat e zeza kriminale të Lubisë, Ballukut, Ergys Agasit, Ermal Beqirit, Vlora Hysenit, Linda Karçanajt, etj., etj.

Ndaj ti sot, nuk ke më fytyrë e kurajo të dalësh para gazetarëve.

Partia Demokratike dënon me forcën më të madhe Edi Ramën, si kreun e narkoshtetit të parë dhe të vetëm në Europë, si kryehajdutin e shqiptarëve, më të madhin e të gjitha kohërave, si kreun e sistemit të llumrave, Ballukëve, Agasve, Hysenve, Beqirve e qindra e qindra të tjerëve si këta, që kanë ndërtuar në Shqipëri shtetin e hajdutëve dhe mafies.

Prandaj kërkojmë dorëheqjen e menjëhershme të Edi Ramës, si kusht themelor, për zgjidhjen e krizës së gjithanshme, që ka kapluar dhe shkatërruar vendin tonë.

Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 27 Shtator19:46

[Rokada/ Ministri Hoxha ndërron ambasadorët në Prishtinë dhe në Shkup](#)

Ferit Hoxha, ministër i Punëve të Jashtme, çon përpara idenë e disa muajve më parë për ndryshimin e dy ambasador&...

POLITIKE 27 Shtator19:28

[‘Asnjë hap pas’/ Dita e 120-të e protestave, pankartat: Edi, po të vjen fundi me ndëshkim!](#)

Sot shënohen 120 ditë protesta qytetare kundër qeverisë së Edi Ramës. Edhe këtë të diel, qytetarët u mbledh...

POLITIKE 27 Shtator19:27

[“Shkoi dhe erdhi si karafil”/ Arben Kola për vizitën e Ramës në SHBA: Bota i ka ‘hequr fishën’, Amerika e braktisi!](#)

Aktivisti Arben Kola ka komentuar vizitën e kryeministrit Edi Rama në SHBA, duke pretenduar se gjatë qëndrimit atje ai nuk është t...

POLITIKE 27 Shtator17:43

[Pse nuk bind alibia e kryeministrit "leshko", që nuk e dinte për Vlora Hysenin dhe Ergys Agasin](#)

Në daljen e tij pas kthimit nga Nju Jorku, Edi Rama përsëriti të njëjtën linjë mbrojtjeje që ka përdorur sa her&eum...

POLITIKE 27 Shtator17:03

[Monologu i Ramës/ Abilekaj: Shmangu gazetarët për të mashtruar pa filtra](#)

Gazetari Enton Abilekaj, i ftuar në ‘Edicionin e Pasdites’ në SYRI TV me moderatorin Edvin Parruca, ka komentuar monologun e kryeministrit...

POLITIKE 27 Shtator16:57

[Shkullaku ironizon Ramën: Pas 28 vitesh në pushtet, paska dalë më i varfër se sa ka hyrë](#)

Gazetari Armand Shkullaku ka reaguar me ironi ndaj Edi Ramës, pas monologut të mbajtur në Rinas. Në reagimin e publikuar në rrjetet so...

POLITIKE 27 Shtator16:38

[Skandali me SHISH/ Rama sulmoi drejtësinë, Tabaku: Shqipëria nuk vuan nga një “republikë prokurorësh”](#)

Deputetja e Partisë Demokratike, Jorida Tabaku, ka reaguar pas deklaratave të kryeministrit Edi Rama, i cili kritikoi drejtësinë dhe institu...

POLITIKE 27 Shtator16:09

[Blushi: Rama firmosi në shkelje të ligjit për inceneratorët, ja dy rastet që e implikojnë](#)

Në një postim në rrjetet sociale, sekretari i Përgjithshëm i Partisë së Lirisë, Tedi Blushi, ka akuzuar kryeministrin Ed...

POLITIKE 27 Shtator15:13

[Ora luksoze dhuratë nga bota e krimit? Rama sulmon deputetët: Pisanjosë me kostum parlamentar](#)

Edi Rama ka reaguar ndaj akuzave të opozitës se ka marrë si dhuratë një orë të shtrënjtë nga krimi i organizuar. Duke ...

POLITIKE 27 Shtator15:05

[Rama ia ngec ndërkombëtarëve fajin për Vlorë Hysenin: Dhanë referenca të mira](#)

Edi Rama reagoi ndaj kërkesave të opozitës për të dhënë shpjegime mbi emërimin e Vlorë Hysenit në krye të SH...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 26 Shtator

[Mbyllet hetimet për vrasjen e gjyqtarit Astrit ...](#)

Prokuroria e Tiranës i ka komunikuar sot Elvis Shkambit akuzën për “vrasje të funksionarëve publikë për shkak të d...

POLITIKE 26 Shtator

[Thirrja “urgjente”/ Rama mesazh shqiptarëve nga...](#)

Nesër sapo të kthehet nga vizita në Kombet e Bashkuara, kryeministri Edi Rama do t’u drejtohet me një mesazh shqiptarëve nga sall...

AKTUALITET 27 Shtator

[Familja e kërkon prej vitesh/ Emisioni italian ...](#)

Rajmonda Kotorri, e cila u largua në Itali kur ishte vetëm 16 vjeçe dhe humbi kontaktet për vite me radhë me familjen e saj, dyshohe...

INVESTIGIME 26 Shtator13:10

[Nga burgu në arrest shtëpie/ Eduard Limaj rikthehet në përndjekje të grave!](#)

Javën e shkuar ju folëm për dramën e një zonje 40-vjeçare, nënë e dy fëmijëve, e cila përndiqej nga 5...

video



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



Nga burgu në arrest shtëpie: Eduard Limaj rikthehet te përndjekja e grave!



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.